




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr.238/2020

Datë: 26 tetor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 18 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe neni 10 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më mbledhjen e 240-të, të mbajtur me 26 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i KGJK-së, i datës 12 shtator 2018, nr. 169/2018, me të cilin caktohet skema e kompensimit, përkatësisht paga e anëtareve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me tekstin, si në vijim:
 1. Kryesuesi, zëvendës kryesuesi i KGJK-së dhe anëtarët me orar të plotë, do të kompensohen në bazë të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
 2. Anëtarët gjyqtarë të KGJK-së, për punën e tyre në Këshill, në komisionet e përhershme dhe/apo të përkohshme të KGJK-së kompensohen në shumën fikse prej 262.75€ për muaj.
 3. Anëtarët jo gjyqtar të Këshillit, kompensohen me pagë bazë ekuivalente me pagën e gjyqtarit të departamentit të përgjithshëm të gjykatës themelore, pa të drejtë kompensimi shtesë për punën e tyre në komisionet e përhershme dhe të përkohshme të KGJK-së.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 26 tetor 2020.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në takimin e datës 27 dhjetor 2017 me vendimin nr. 368/2017, kishte përcaktuar skemën e kompensimit, përkatësisht pagën e anëtareve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërmarrja e një vendimi të tillë kishte ardhur si rezultat i zgjedhjes së anëtares së re nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtare e jo gjyqtare e nga radhët e komunitetit jo shumicë të Kosovës, e cila ishte e pa punësuar. Bazuar në këtë, Këshilli në mbështetje të nenit 3 paragrafi 7 të Ligjit Nr.05/L-033 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës kishte vendosur që të caktohej skemën e kompensimit, përkatësisht pagën e anëtareve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mënyrë që anëtarët jo gjyqtar të Këshillit të kompensohen me pagë bazë ekuivalente me pagën e Gjyqtarit të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, pa të drejtë kompensimi shtesë.

Mirëpo pas shpalljes së aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në mbështetje të vendimit të Qeverisë, Vendimin nr. 04/20 të datës 20 dhjetor 2017 për ndryshimin dhe rritjen e pagës bruto

te funksionareve shtetërore dhe të disa vartësve, me datë 12 shtator 2018, KGJK me qëllim të kursimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës analizoj rrethanat e reja të krijuara dhe vendosi që të rishqyrtoj vendimin nr. 368/2017, të datës 27 dhjetor 2017 me të cilin caktohet skema e kompensimit prej 25% të bagës bazë të gjyqtarit duke e ulur shumën e kompensimit për anëtarët gjyqtar të Këshillit.

Kuvendi i Kosovës më datë 13 gusht 2020, sërish ka zgjedhur një anëtar të ri të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht z. Vilard Bytyqi, i cili po ashtu është anëtarë jo gjyqtarë i Këshillit, por që i njëjti është i angazhuar si mësimdhënës në nivelin e lartë akademik.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës me nr. 06/L-055, në nenin 18 paragrafi 2, ka paraparë që edhe anëtarët jo gjyqtarë të KGJK-së, që nuk janë gjyqtarë kanë të drejtë në kompensimin e punës së tyre, si anëtarë të këshilli, sipas skemës që miratohet nga KGJK. Ndërsa me paragrafin 5 të po këtij neni përcaktohet se kryesuesi, zëvendës kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të KGJK-së nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyre tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

Për arsyet e sipërshënuara, KGJK në takimin e datës 26 tetor 2020, miratoj skemën e kompensimit me të cilën në mënyrë specifike përcaktoj mënyrat e kompensimit të secilës kategori të anëtarëve të KGJK-së.

Me sa u tha me larte, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Skender COÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Departamentit të Administratës së Përgjithshme, si dhe
- Arkivit.